




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (LVL) nr. 03/L-040 dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës 01. nr. 016-126211 të dt. 06.11.2014 me ndryshimet dhe plotësimet në Statut 01. nr. 016-28448 të dt. 22.03.2018, dhe në zbatim të nenit 36 dhe 42 të Rregullores (QRK) nr.22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe menaxhimin e programit të riintegritimit në pajtim me Strategjinë Shtetërore për Riintegrim të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar në Kosovë, Kryetari i Komunës së Gjiçanit merr këtë:

V E N D I M

për formimin e grupit punues për hartimin e Planit Lokal të Veprimit për Riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Gjiçanit 2026-2028

1. Miratohet vendimi për formimin e Grupit punues për hartimin e Planit Lokal të Veprimit për Riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Gjiçanit, në këtë përbërje:

- 1.1. Salihe Aliu, kryetare,
- 1.2. Mursel Zymberi, anëtar,
- 1.3. Liridona Ukshini Kosumi anëtare,
- 1.4. Burim Kryeziu, anëtar
- 1.5. Burim Elezi, anëtar,
- 1.6. Elez Kurteshi, anëtar.
- 1.7. Teuta Kurtalani, anëtare,
- 1.8. Mexhid Selimi, anëtar dhe
- 1.9. Ganimete Kastrati, anëtare
- 1.10. Fetah Jerliu, anëtar dhe
- 1.11. Flokart Klaiqi, anëtar

2. Grupi punues nga pika 1 e këtij vendimi, ka për detyrë hartimin e Planit Lokal të Veprimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve, në përputhje me obligimet dhe përgjegjësitë që i takojnë secilës drejtori, me theks të veçantë Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Qendrës për Punë Sociale.

3. Bazuar në Planin Lokal të Veprimit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Rregulloren nr.22/2020 për Riintegrimin e personave të riatdhesuar, Komuna është përgjegjëse për sigurimin e banimit, përfshirë bonusin e banimit të përshtatshëm për personat e riatdhesuar. Kjo përgjegjësi buron gjithashtu nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligji për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, sipas të cilave Komuna ka obligim të sigurojë banim për qytetarët e saj në nevojë.

4. Për zbatimin e këtij vendimi përgjegjës është Grupi Punues i formuar me këtë vendim, ndërsa mbikëqyrjen e punës së tij e ushtron Kryetari i Komunës.
5. Mandati i Grupit punues zgjatë deri në përfundimin e hartimit të Draft Planit Lokal të Veprimit për Riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve, miratimin e tij nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit si dhe konfirmimin e ligjshmërisë nga organi kompetent.
6. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit.

Vendimi i dorëzohet:

1. Anëtarëve të GP
2. DSHMS dhe
2. Arkivit

